



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 129, dt. 25.05.2016

Në mbështetje të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 25.05.2016, pasi shqyrtoi propozimin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratohet propozimi i kufirit të zonës së mundshme për shpallje pasuri botërore e UNESCO-s në kuadër të projektit për rajonin e liqenit të Ohrit, bazuar në rezultatet e misionit të përbashkët në terren: UNESCO, ICOMOS, IUCN, IMK, AKZM, ARZM, Bashkia Pogradec, IA.
2. Miratohet *opsioni 3* i propozuar i këtij kufiri ku përfshihet: “*Vija e Bregut të Liqenit, veçoritë Kulturore të pejsazhit të Gadishullit të Linit dhe Fshati Lin, Zonat Kritike për integritetin skenik të Liqenit (Driloni, pjesa e bregut në veri të Linit), zonat ku janë identifikuar vendbanimet palafite*”
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR
ARTA DOLLANI